



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 26 qershor 2026, në mbledhjen e VI-të (gjashtë) -e rregullt, mandati VIII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Isak Shabani, Haki Rudari, Artrit Mulliqi, Adelinë Stublla, Qëndresë Hajrizi, Enis Shabani, Ekrem Rrahmani, Mimoza Abdullahu), ndërsa mungoi Alisa Jetullahu. (Lista e nënshkrimeve)

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin; z.Fahri Restelica Nënkyetar i Komunës, znj.Arbnorë Uka Osmani, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave

Rendi i ditës

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar punë të mbarë, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, sigurisht që thirrjen dhe materialin e kësaj mbledhje e keni marrë me kohë dhe keni mund t'i shihni pikate e rendit të ditës (lexon pikate e rendit të ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje). Tani e hapi këtë mbledhje, urdhëroni a dëshironi ndokush fjalën rreth rendit të ditës.

z.Fahri Restelica, Nënkyetar i Komunës, theksoi, përshëndetje për të gjithë, në emër të Kryetarit të Komunës paraqes një pikë shtesë që është propozim vendim për miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës njësia kadastrale P-71712029-00209-0 sipërfaqja 38882 m² Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm, gjithashtu në kuadër të kësaj pike kemi edhe nënpikën propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues për zhvillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të kësaj parcele, kështu që ju kisha lut që të votoni që të hyjë si pikë shtesë në këtë mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa, të shqyrtohet dhe pastaj t'i rekomandohet Kuvendit si pikë shtesë dhe shqyrtim të të njëjtës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë u paraqit ky propozim nga Nënkyetari i Komunës dhe e kemi materialin e këtyre dy pikave, unë kërkoj t'ju shpërndahet të gjithëve dhe njëkohësisht të mbajmë një pauzë të shkurtër rreth 2-3 minuta deri të shfletoni këto dokumente dhe pastaj të hapim diskutimet.

I nderura Nënkyetar, sa jam në dijeni unë për një parcelë aty ngjithë me këtë që u propozua ne veç kemi marrë vendim në njërën prej mbledhjeve të kaluara

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kjo pronë është votuar në kuadër të listës së përgjithshme, janë 8 hektar dhe ka qenë e planifikuar të dal në shqyrtim në periudhën mars-qershor.

z.Fahri Restelica, Nënkryetar i Komunës, duke i' i përgjigje parafolësit, theksoi, është pjesë tjetër kjo që u propozua tani, mirëpo mbi të gjitha drejtoresha e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë do t'i jap sqarimet e nevojshme në mbledhjen e Kuvendit.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, nëse nuk ka të interesuar tjerë për të marrë fjalën, atëherë e hedhë në votim propozim vendimin e Kryetarit të Komunës i prezantuar nga Nënkryetari i Komunës që të hyjë në rend të ditës si pikë shtesë në këtë mbledhje dhe që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës, së bashku me propozim vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënien e kësaj prone në shfrytëzim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se nga 8 anëtar/e të Komitetit sa ishin prezent, me 6 vota Për, 2 vota Kundër, asnjë votë Të Përmbajtur, mbështet propozimi i Kryetarit të Komunës, prezantuar nga Nënkryetari i Komunës, që në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje të përfshihen si pikë/nënpikë shtesë dhe që t'i rekomandohen Kuvendit për shqyrtim, dhe atë: (me renditje në pikën 6 të rendit të ditës)

- **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia kadastrale P-71712029-00209-0 në sipërfaqe 38882 m², ZK Lupç i Poshtëm**
- **Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia Kadastrale parcelë: P-71712029-00209-0, në sipërfaqe 38882 m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm**

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, e mora fjalën që të arsyetoj vetën pse votuam kundër, unë edhe në listë të përgjithshme kur ka qenë kjo pronë kam qenë kundër sepse jam kundër që prona të jepet për 99 vite, por edhe për shkak të mënyrës se si po sjellën këto propozime kështu për ngut. Ne e kemi votuar një listë të përgjithshme dhe nëse hyn në faqe të Komunës e sheh që me plan është të sjellët në muajt mars-qershor, andaj pse nuk ka ardhur në Kuvend deri tani ose me procedurë të rregullt, por gjithmonë po sjellën pikat kështu për ngutë. Po ashtu nuk pak ajo hapësirë dhe këtë e them sepse unë kam qenë disa herë te ajo pronë prej 38 hektarësh, pra janë shumë. Është shumë interesant pse këto pika vinë kaq për ngut e që unë konsideroj se që këto të trajtohen seriozisht, por në këtë formë mua më bën të dyshoj që sipas këtij propozimi të Kryetarit të Komunës mund të ketë ardhur ndokush dhe i ka thënë procedoje në Kuvend këtë sepse dëshiroj që ta marr në shfrytëzim, prandaj e them se këto çështje duhet të shkojnë me radhë sepse ne për këtë arsyeje e kemi votuar një listë në Kuvend e që në atë listë është e planifikuar që kjo pikë të sjellët në Kuvend në muajt mars-qershor, jo në këtë kohë tani, por si duket vie kur të dojë Kryetari, andaj për këtë arsyeje unë votoj kundër e që edhe në seancën e Kuvendit do të votoj kundër.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse dikush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim rendin e ditës duke e përfshirë edhe propozimin e Kryetarit të Komunës të cilin e paraqiti Nënkryetari i Komunës dhe që u mbështet paraprakisht me shumicë të votave.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialeve përkatëse të dërguara me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe pikën/nënpikën shtesë e cila u mbështet paraprakisht.

Rendi i miratuar i ditës.

1. *Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 26.05.2026*
2. *Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2025 në vitin 2026 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore*
3. *Propozim vendimi për transfer / rialokim të buxhetit të Komunës së Podujevës dhe destinimi në kategori dhe programe të caktuara buxhetore*
4. *Korniza Afatmesme Buxhetore-KAB e Komunës së Podujevës, për vitet 2027/2029*
5. *Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit-ZKA për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për 2025.*
- 5.1. *Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e ZKA*
6. *Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia kadastrale P-71712029-00209-0 në sipërfaqe 38882 m², ZK Lupç i Poshtëm*
- 6.1. *Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia Kadastrale parcelë: P-71712029- 00209-0, në sipërfaqe 38882 m², ZK Lupç i Poshtëm*

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 26.05.2026

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtij procesverbali nga mbledhja e KPF-së e datës 26.05.2026, nëse jo atëherë e hedh në votim që të miratohet sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit që ishin prezent në mbledhje, pa plotësim ndryshime apo vërejtje eventuale, miratohet Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 26.05.2026, sipas dokumentit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

2. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2025 në vitin 2026 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore

znj.Arbnorë Uka Osmani, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, besojë që materialin e keni pranuar dhe keni pasur mundësi që të lexoni dhe të vlerësoni, pra para jush keni propozim vendimin për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2025 në vitin 2026 dhe destinimi në kategori dhe programe të caktuara buxhetore.

Të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës të pa shpenzuara për vitin 2025 në shumën e gjithmbarshme 1,440,443.17 € nga e cila, vlera prej 832,008.11 € është tejkalim i të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2025 dhe të gjitha këto bartën në vitin 2026 sipas programeve dhe kategorive të mëposhtme;

-Në kategorinë e shpenzimeve kapitale në nën-programin planifikimi dhe zhvillimi ekonomik për projektin ndërtimi i tregut të ri të qytetit Kodi i projektit 55189 ku vlera e kësaj është 252,682.40€, kjo përkrahje për këtë projekt bëhet si rezultat i obligimeve kontraktuale dhe punimeve që priten të kryhen gjatë vitit 2026 dhe përfundimi i projektit në tërësi.

-Për infrastrukturën publike projekti rregullimi i infrastrukturës së varrezave të qytetit në vlerë 115,510.48€ edhe kjo po ashtu ka të bëjë me obligime kontraktuale dhe punë që priten të kryhen gjatë vitit 2026 dhe përcjellje të punimeve edhe për vitet e ardhshme pasi që vlera e projektit është më e madhe se sa kjo vlerë.

-Planifikimi hapësinor dhe rregullativ për projektin zgjerimi ndërtimi dhe asfaltimi i rr“Xhemajl Mustafa” dhe me infrastrukturë përcjellëse vlera 147,627.96€.

-Për projektin tjetër ndërtimi i rrugës lidhëse nga magjistrallja Podujevë-Prishtinë deri në rr.“Vëllezërit Frashëri” si dhe rrugën “Shaban Shala” dhe “28 nëntori”, vlera 153,849.67€, këto projekte janë të rëndësishme që të përmbyllën ku njëri projekt veç është i përfunduar, pra fjala është për projektin rr.“Vëllezërit Frashëri” pasi që kemi një faturë të pa paguar, dhe projekti tjetër që pritet që të finalizohet dhe janë obligime kontraktuale.

-Programi shërbimet e shëndetësisë primare në projektin ndërtimi i QMF-së Podujevë bashkëfinancim me Qatar Charity ku ka mbetur një vlerë e pa përmbushur 77,829.00€ është vlera e këtij projekti që të finalizohet dhe kjo ka mbetur si rezultat finalizimit të punimeve dhe për shkak të pamundësisë së pagesave me kohë.

-Te arsimi parafillor te Çerdhet, ndërtimi i kuzhinës qendrore për fëmijë në çerdhe dhe në shkolla në Podujevë ku vlera e kësaj është 203,000.00€ pagesë prej të hyrave vetanake që priten të realizohen, pra këto projekte bartën në këtë program për shkak që kemi obligime kontraktuale dhe punët që priten të kryhen deri në fund të vitit 2026 dhe finalizimi i tërësishëm i projekteve.

-Te arsimi fillor kemi ndërtimin e sallës së brendshme sportive në shkollën “Ali Ajeti” në fshatin Sfeqël ku vlera e këtij projekti është 206,452.34€, ndërtimi i shkollës “Hasan Ramadani” në fshatin Shajkoc ku vlera e këtij projekti është 75,730.24€, ndërtimi i aneksit të shkollës “Naum Veqilharxhi” në fshatin Llapashticë kodi i projektit 45,938.00 €, projekti ndërtimi i sallë së brendshme sportive, ndërtimi i shkollës në Shajkoc dhe aneksi i shkollës në Llapashticë janë edhe një pjesë e punimeve që priten të finalizohen komplet projekti në tersi.

-Në kategorie e mallrave kemi te arsimi fillor furnizimi me lëndë djegëse për dru shuma 86,00.00€ ku një pjesë e furnizimeve është bërë gjatë muajit janar, mirëpo për shkak të mungesës së fondeve kemi mbetur në vonesë me pagesa.

-Në kategorinë e shpenzimeve komunale kemi një pjesë të administratës në shumë 24,293.00€, një pjesë të shërbimit të kujdesit primar shëndetësor 20,132.00€, te arsimi para fillor çerdhet 1,264€, te arsimi i mesëm kemi shpenzime komunale 30,134.00€, vlera e gjithmbarshme e shpenzimeve komunale që pritet të vijnë deri në fund të vitit 2026 është 75,823.08 €, kjo për shkak të vendimeve gjyqësore të vitit të kaluar dhe obligimeve të papaguara që kishim në fillim të vitit 2026 dhe ato pagesa janë kryer, mirëpo këto shpenzime deri në fund të vitit pritet që të ndodhin prandaj kemi marr parasysh që një pjesë të mjeteve ti ndajmë edhe për shpenzime komunale, prandaj për të gjitha këto pres përkrahje nga ana e juaj.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, përshëndetje për të gjithë, në emër të Grupit të LVV e përkrahim dhe e mbështetim këtë pikë të rendit të ditës që të rekomandohet për seancën e Kuvendit, të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet tona do t'i përcjellim në Kuvend.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe ne Grupi i LDK-së e përkrahim që kjo pikë të kaloj në Kuvend për diskutim, natyrisht i kemi vërejtjet tona dhe besoj që drejtoresha e DBF është e gatshme që të na jap më shumë sqarime edhe pse kjo këtu tani është vetëm dhe nuk e kuptoj pse nuk është drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe disa drejtor të Drejtorive tjera që të shpërndahet përgjegjësia. Megjithatë ne e përkrahim që kjo pikë të shkoj në Kuvend.

znj.Mimoza Abdullahu, theksoi, në emër të Grupit të PDK-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës për rekomandim në Kuvend.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse dikush tjetër dëshiron fjalën rreth kësaj pike, nëse jo atëherë e hedhë në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit që ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij Propozim vendimi, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

3. Propozim vendimi për transfer / rialokim të buxhetit të Komunës së Podujevës dhe destinimi në kategori dhe programe të caktuara buxhetore

znj.Arbnorë Uka Osmani, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, para jush keni propozim vendimin për transfer / rialokim të buxhetit të Komunës së Podujevës dhe destinimi në kategori dhe programe të caktuara buxhetore, pra kemi të bëjmë me transfer të mjeteve buxhetore nga kategoria e subvencioneve, nga programi planifikimi dhe zhvillimi ekonomik që të ri-destinohen tek bujqësia në vlerë 45,000.00€, për shkak që planifikojmë që t'i subvencionojmë bujqit në litër qumësht në blegtori për këtë periudhë deri në fund të vitit.

Transferi i mjeteve nga kategoria kapitale është nga programi arsimit fillor ku nga projekti tabelat dixhitale vlera 100,000.00€ ri-destinohen te programi arsimit i mesëm kategoria ekonomike kapitale, te ndërtimi i një objekti të shkollës së mesme te kampusi i shkollave te mesme, pra është vlera e njëjtë 100,000.00€ që priten të bartën në këtë projekt dhe kjo bëhet për arsyeje që te tabelat dixhitale e kemi parë më të nevojshme që të zvogëlohen shumat nga 150,000.00€ në 100,000.00€ në këtë vit, ndërsa të përkrahet projekti ndërtimi i shkollës së mesme te kampusi i shkollave te mesme për shkak të obligimeve kontraktuale dhe punët që priten të kryhen deri në fund të vitit 2026.

Po ashtu kemi ri-destinim apo transfer të mjeteve nga programi arsimit fillor te projekti ndërtimi i aneksit të shkollës "Xheladin Rekaliu". Te programi arsimit i mesëm po ashtu projekti i njëjtë paraprak ndërtimi i një objekti të shkollës së mesme te kampusi i shkollave të mesme ku vlera është 200,000.00€, kjo bëhet për shkak që projekti ndërtimi i objektit të aneksit të shkollës "Xheladin Rekaliu" ende nuk është iniciuar procedura e prokurimit, ndërsa kemi nevojë që të përkrahim këtë projekt me qëllim të finalizimit, pra objekti te kampusi i shkollave të mesme në vlerë prej 200,000.00€ me qëllim që të finalizohen projekti dhe shkolla te jetë e gatshme në fund të këtij viti apo fillim të vitit të ardhshëm.

Kërkoj nga ana e juaj përkrahje për këto që unë sot i paraqita këtu para jush.

znj.Qëndresë Hajrizi, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim këtë propozim vendim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim në seancën e radhës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë besoj që këtë nuk e kalon Ministria sepse të njëjtin rast e kemi pasur në vitin 2023 ku MAPL e ka kthyer të ligjshme ndërsa Ministria tjetër përkatëse nuk e ka pranuar.

E përmendi drejtoresha parafolëse ndërtimin e një aneksi të shkollës "Xheladin Rekaliu" kanë qenë 200,000.00€ dhe të merren 100% të mjeteve të dërgohen te shkolla "Isa Boletini", kurse ne si Kuvend kemi të drejtë 15% të një kodi t'i zhvendosim, por jo më shumë, prandaj e ceka se këtë Ministria nuk e pranon dhe unë jam kundër kësaj, pastaj arsyeja pse jam kundër kësaj është edhe një tjetër që më shtyn të jem kundër, kur ne i kemi ndarë 2,000,000.00€ për shkollën ekonomike dhe ka pasur kompani që kanë konkurruar me 1,900,000.00€ dhe i është dhënë tenderi kompanisë më të shtrenjtë dhe i ka kaluar 7 kompani të tjera dhe është dhënë tender 2,700,000.00€, unë jam kundër kësaj pike dhe mendoj që Ministria nuk e pranon dhe është mirë që pasi nuk e pranon Ministria të vie drejtoresha e DBF-së këtu në foltore dhe të thekson që mirë e kam pasur unë, sepse nganjëherë është edhe mirë të pranohen gabimet.

Edhe te subvencionet që u përmenden më herët dua të di se kush është ai ekspert, shembull që i'a heq 45,000.00€ bizneseve dhe i'a jep bujqësisë, le të del ai që t'më bind mua se më mirë është t'iu hiqen bizneseve dhe t'iu jepen bujqësisë sepse në bujqësi është ky apo ai fitim, unë do të votoj Për, mirëpo deri sa vetëm dalin dhe i sjellin parat herë andej herë këndeje, unë nuk e di arsyen pse. Këtë e them sepse këto para te zhvillimi ekonomik kanë qenë të destinuara për biznese dhe për Ndërmarrje Publike, kurse tani po i dërgojmë në bujqësi, a po i bie kjo që ne po i dënojmë bizneset dhe se ka qenë vetëm për tua marrë votën dhe tani t'i kthejmë këto para në bujqësi, është e komplikuar kjo punë.

Pra duhet të del eksperti të na tregoj arsyejen që Komuna ka fitim më shumë prej kësaj sepse nëse ne në fushatë bëjmë vetëm premtime dhe del Kryetari i Komunës në çdo televizion e program që thotë

400,000.00€ do ti japim për biznese, tani hiqet shuma 50,000.00€ dhe 45,000.00€, dhe mbeten vetëm 295,000.00€, duhet ta dim pse, pra kjo kërkon analizë dhe duhet të dimë pse po barten këto para.

znj.Arbnorë Uka Osmani, U.D. drejtoresh e DBF, theksoi, vetëm sa për sqarim, këto nuk janë për serra, por e ceka dhe është e theksuar edhe në arsyetim, pra ka të bëjë subvencion për litër qumësht në blegtori, pra Komuna as në këtë rast nuk fiton dhe as në rastin kur i subvencionon bizneset, por qytetarët përfitojnë dhe esenca në këtë rast është të përkrahët blegtori. Nuk është vlerë e madhe 45,000.00€, ne e dimë që komunat tjera kanë filluar me vlera më të mëdha, mirëpo për këtë vit është si nisëm e mirë.

Sa i përket asaj që Ministria nuk e pranon, unë mendoj që Ministria do ta pranojë këtë, në vitin 2023 nuk e di se si ka ndodhur por po e them se kjo është në kuadër të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, është nën 15% këto bartje që po ndodhin nga një program në programin tjetër, pra jo në projekte por në programe, pra nëse merret në total programi si ato që i ceke ti i nderuar Rrahmani besoj që kalon, por nëse nuk kalon dhe ti e ke mirë, unë nuk e kam problem të them që ke pas të drejtë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse dikush tjetër dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës, për rekomandim dhe shqyrtim në Kuvend.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit që ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij Propozim vendimi, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

4. Korniza Afatmesme Buxhetore-KAB e Komunës së Podujevës, për vitet 2027/2029

znj.Arbnorë Uka Osmani, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, para jush keni dokumentin e Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Podujevës për vitet 2027-2029, ky dokument është përgatitur në përputhje me udhëzimet e Qarkores Buxhetore e cila në sfond dhe kontekst të vetin ka prioritetet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve. Pra në pika të shkurta sepse është dokument voluminoz dhe se kemi kohë edhe gjatë seancës Kuvendit ku mund të diskutojmë me detaje.

Atëherë i gjithë buxheti i planifikuar për vitin 2027 për Komunën e Podujevës është 35,849,048.00€, ndërsa projeksionet për vitet 2028-2029 është 37,425,150.00€ për vitin 2028 dhe për vitin 2029 vlera është 39,444,425.00€. Nga të hyrat vetanake për vitin 2027 janë planifikuar 2,483,340.00€ ndërsa nga granti qeveritar është 33,365,708.00€. Ky dokument është përgatitur në përputhje me këtë Qarkore dhe është bërë ndarja në programe dhe në kategori të ndryshme ekonomike, në këtë rast e kemi përkrahur me afër 5,000,000.00€ Drejtorinë e Arsimit si dhe për me pak se 500,000.00€ e kemi përkrahur Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dhe atë duke i parë nevojat e mëdha në këta dy sektorë.

Ju falënderoj shumë dhe pres komente nga ana juaj. Po ashtu ju informoj se Kuvend do t'i propozoj disa përmirësime të vogla teknike në këtë dokument ku sot gjatë shpalosjes kam parë që janë 2-3 gabime teknike që kërkoj të përmirësohen në mënyrë që dokumenti final të miratohet në rregull, gabime të cilat teknike dhe atë në faqe 9 ku te të hyrat vetanake vlera 2,280,518.00€ duhet të jetë 2,483.340.00€, pjesa tjetër e dokumentit është në rregull, mirëpo nuk e di pse kjo tabelë nuk është bërë siç duhet, pra kjo vlerë duhet të përmirësohet. Po ashtu në faqen 25 tek të hyrat vetanake duhet të përmirësohet dhe të vendoset vlera 2,483.340.00€ si dhe po ashtu edhe te granti qeveritar duhet të përmirësohet 33,365.708.00€, si dhe në faqen 26 duhet të jetë vlera tek të hyrat vetanake 2,483,340.00€.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, në emër të Grupit të LVV e mbështesim dhe rekomandojmë që kjo pikë e rendit të ditës të shkojë për shqyrtim në Kuvendin e Komunës për seancën e radhës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe ne Grup i LDK-së e përkrahim që të diskutohet në Kuvend, por edhe ne i kemi disa propozime tona nëse ka mundësi të përfshihen, mirëpo unë kam edhe disa shqetësime që mund t'i përmendi disa prej tyre; shembull për vitin 2027 janë 21 projekte nën 35,000.00€, në vitin 2028 27 projekte nën 35,000.00€, dhe në vitin 2029 prapë 21 projekte nën 35,000.00€, pra kemi 69 projekte që maksimum i ke me shumën 35,000.00€, madje janë shkruar vetëm fshatrat dhe nuk e di se çfarë mund të bëhet me këto shuma, kemi raste kur fshatrat janë shumë të vogla dhe ndonjë rrugicë mund ta asfaltosh, por lind pyetja pse nuk përmenden emrat e rrugëve, pse nuk i shkruani në prioritet, shembull në fshatin Gllamnik apo Siboc do të asfaltohen këto rrugë.... pra është prioritet dhe në rregull, e them këtë sepse neve si anëtar të Kuvendit nëse na pyesin qytetarët për çka janë ndarë ato mjete në fshatin Siboc ne nuk dimë ti tregojmë. Unë e kam përmend disa herë fshatin Siboc dhe po e përmendi edhe këtë herë sepse edhe në dokumente dhe në gjeoportali janë dy fshatra, kurse shkruan se në fshatin Siboc ndahen 35,000.00€ dhe ne nuk e dimë se për cilin Siboc bëhet fjalë, Siboc të Poshtëm apo Siboc të Epërm, edhe pse mund ta di sepse zakonisht ato shkojnë në Siboc të Epërm sepse unë jam i Sibocit të Poshtëm dhe dënohet fshati jem sepse jam anëtar i LDK-së, prandaj përse të mos jetë e shkruar sepse ky buxhet për vitet 2027, 2028, 2029 do të ndahen në këtë vend dhe se ne i dimë vendet me prioritet të cilat kanë nevojë për rrugë apo trotuar, por ju duhet të jeni më korrekt.

Unë i përcjell edhe procesverbalet e më hershme, shembull edhe në ditët që veç sa kanë filluar të emërtohen rrugët, vetëm ti shikosh diskutimet e anëtareve të LVV-së e që e kanë pasur me të drejtë, lind pyetje pse nuk tregohet me emër të rrugës së ku do të asfaltohet rruga dhe të dimë se ku po shkon ky investim sepse jemi në vitin 2026 tani, madje as për vitin 2029 nuk kemi ndonjë emërtim të rrugës që do të theksonte se në këtë rrugë do të ketë investim. Unë nuk kam problem me asnjë rrugë por ju duhet t'ia përmendi emrin asaj rruge ku do të investoni dhe që e keni parë më të arsyeshme për të investuar, pra me një fjalë të jeni sa më korrekt ju, dhe ne të dimë se çfarë po votojmë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse dëshiron dikush të merr fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës si dhe plotësim ndryshimet apo korrigjimet e paraqitura nga drejtoresha e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, për rekomandim dhe shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit që ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të Kornizës Afatmesme Buxhetore, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, si dhe plotësim-ndryshimet apo korrigjimet e paraqitura nga drejtoresha e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, si në vijim:

-Në faqet 9; 25; 26 të dokumentit të KAB, rubrikat ku figuron shuma financiar 2,280,518.00€, ndryshohet me shumën 2,483,340.00€, si dhe rubrikat ku figuron shuma financiar 33,568,530.00€, ndryshohet me shumën 33,365,708.00€.

5. Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit - ZKA për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin 2025.

5.1. Plan i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e ZKA

z.Isak Shabani, Kryesuesi i Komitetit, theksoi, edhe këtë pikë të rendit të ditës së bashku me planin e veprimit do t'i prezantoj drejtoresha e Drejtorisë së buxhetit dhe Financave, urdhëroni e nderuar.

znj.Arbnorë Uka Osmani, U.D. drejtoresh e DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, para jush gjeni Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin 2025 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, siç e keni lexuar edhe ju, pra kemi opinion të kualifikuar të pasqyrave financiare si rezultat i shpenzimeve të prezantuara në pasqyrën financiare kanë qenë të keq klasifikuara në vlerën 3,653.581.00€ si rezultat i vendimeve gjyqësore të cilën e kemi cekur vazhdimisht. Përveç që kemi pasur probleme në realizim të projekteve po ashtu jemi klasifikuar në pasqyrat financiare si raport i kualifikuar i pasqyrave financiare. Në këtë raport kemi gjithsej 11 rekomandime nga të cilat 3 janë të reja, 7 janë të përsëritura dhe 1 pjesërisht e përsëritur, pra vlen të përmendet që ka rekomandime të cilat edhe janë përmbushur. Pres diskutim gjatë seancës dhe nëse ju nevojitet ende material mund t'ju sjellim pa tjetër.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë nuk jam i kënaqur me këtë raport sepse është viti i pestë që ne dalim me raport të kualifikuar, e kemi gjetur paksa një arsyetim që po thuhet po merren parat nga kontrata kolektive, por në fakt jemi duku u fshehur pas saj sepse ka edhe shumë gjëra tjera që i përmend raporti qoftë për vonesa të lejeve, qoftë për vonesa të parave për kontratkorët që i kryejnë punët, për dhënie të tenderëve pa asnjë kriter dhe shumë gjëra tjera që janë shumë keq, mirëpo edhe në raport tregohet për rastet të cilat janë të përsëritura, e që mendoj se nuk do të përsëriteshin por që nuk është duke funksionuar shteti dhe gjykatat, por që ZKA pavarësisht qysh është raporti, normal që duhet të dorëzoj në prokurori sepse ka shumë gjëra serioze e që nuk është mirë për qytetin ton kjo punë. E them këtë sepse ka pas këtu ish zyrtar të prokurimit që kur i kam thënë jeni duke i shkelur procedurat, më kanë shikuar mrrrolët, kurse tani kanë filluar të dalin këto në shesh, në fakt tani këta e kanë marr vesh që i kanë heq ata, por tash ai ka filluar të blej shtëpia, prona dhe të rregulloj shtëpi, pra këtu po dihet që parat po shkojnë diku, ne nëse dëshirojmë të fshehim mundem ta bëjmë, mirëpo raporti është shumë i zi dhe i keq.

Nena po e shohim se gati në gjithë Kosovën ka lulëzuar kjo punë, mirëpo të del raporti që 4 herë i kualifikuar dhe të përsëriten prap gjetjet e njëjta, aq më shumë duke ditur se si i merr mostrat Auditori, po nëse hyn më në detaje del shumë keq. Lutem që të rregullohet ndonjëherë ky vend dhe nuk ka lidhje fare kush është në pozitë / pushtet, mirëpo raporti të dal kështu, është shumë keq.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, e nderuar drejtoresh për plan të veprimit a dëshironi të theksoni diçka.

znj.Arbnorë Uka Osmani, U.D. drejtoresh e DBF, theksoi, për Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të ZKA-së është vetëm një plan i cili është pjesë e raportit dhe nuk e di përse praktikohet të sjellët në Kuvend sepse nuk kërkohet miratim apo diçka e ngjashme, pra është vetëm plan i të cilin e përgatit Ekzekutivi dhe që ka për ta zbatuar po vet Ekzekutivi i Komunës, andaj nuk kam diçka për këtë dokument.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, atëherë në rregull, nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës, për rekomandim dhe shqyrtim në Kuvend.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit që ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim të kësaj piket të rendit të ditës, sipas materialeve përkatëse të dërguara me thirrjen e mbledhjes.

6. Propozim vendimi për miratim paraparak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia kadastrale P-71712029-00209-0 në sipërfaqe 38882 m², ZK Lupç i Poshtëm

6.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia Kadastrale parcelë: P-71712029-00209-0, në sipërfaqe 38882 m², ZK Lupç i Poshtëm

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës u diskutua edhe në fillim të mbledhjes kur u propozua të hynë pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës, mirëpo edhe tani është në diskutim dhe urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës, për rekomandim dhe shqyrtim në Kuvend.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, konstatoi se nga 8 anëtar/e të Komitetit sa ishin prezent, me 7 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë Të Përmbajtur, (1 anëtar nuk votoi), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për përfshirje si pika shtesë në kuadër të rendit të ditës dhe njëkohësisht shqyrtimin e këtyre propozim vendimeve të Kryetarit të Komunës, të prezantuar nga Nënkryetari i Komunës, sipas materialit përkatës të shpërndarë në këtë mbledhje të KPF-së dhe bashkëngjitur këtyre konstatimeve.

Duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë rreth kësaj mbledhje, Kryesuesi i Komitetit e konstaton të përfunduar dhe njëkohësisht i njoftuar se Konstatimet e rekomanduara në bashku me materialet përkatëse nga kjo mbledhje sot do t'ju procedohen / dërgohen anëtarëve të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45

Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;

Enis Sheholli

Arbrim Idrizi

Nr.Prot.01-060/04-0037088/26

Podujevë,

26 qershor 2026

Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit

Isak Shabani